# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2023 – Numri: 90

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 21 qershor 2023**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 31.5.2023 | Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.......... | 9573 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 31.5.2023 | Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.......... | 9575 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 31.5.2023 | Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të pozicioneve koordinator të rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit në disa institucione të administratës shtetërore.......... | 9577 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 31.5.2023 | Për përcaktimin e pagave të punonjësve të personelit shqiptar të misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, si dhe të punonjësve të tjerë shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, si oficerë kontakti, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe si prokuror ndërlidhës pranë *EUROJUST* në Hagë, Holandë.......... | 9581 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 | Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.......... | 9587 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023 | Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike. | 9625 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 31.5.2023 | Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe përcaktimin e klasës së pagës së diplomatëve të karrierës që punojnë në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.......... | 9639 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023 | Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.......... | 9640 |

**VENDIM**
**Nr. 321, datë 31.5.2023**

## PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të pikave 1, shkronja "a" dhe 3, të nenit 70, të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", dhe të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore me status të veçantë (në vijim "punonjësit e Agjencisë"), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore";

b) nëpunësit civilë të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;

c) punonjësit administrativë/mbështetës të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element për punonjësit e Agjencisë janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për funksion, që përfaqëson nivelin e pagës për çdo funksion organik të punonjësve të Agjencisë, përcaktohet në kolonën 2, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që është shtesa që përfitojnë punonjësit e Agjencisë, për shkak të veçorisë së punës e shërbimeve që kryejnë, përcaktohet në kolonën 3, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Shtesa për vjetërsi në punë është shtesa që përfitojnë për çdo vit vjetërsie në detyrë dhe llogaritet në masën 1 (një) për qind të:

i. pagës për funksion, për funksionet organike "ndihmësspecialist" dhe "specialist në drejtoritë rajonale", por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet;

ii. pagës për funksion të funksionit organik "specialist në Drejtorinë e Përgjithshme", për të gjitha funksionet e tjera organike, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës për çdo vit vjetërsie në detyrë, sipas shkronjës "c", të pikës 2, të këtij vendimi, "vite vjetërsie" në detyrë do të konsiderohen:

a) vitet e qëndrimit në detyrë, të dokumentuara me librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, së çdo punonjësi në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore dhe në ish-Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;

b) vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara me librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, së çdo punonjësi në strukturat e Gardës së Republikës, Policisë së Shtetit, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

4. Gjatë periudhës së trajnimit në Akademinë e Sigurisë, aplikantët, të cilët shpallen fitues dhe që në momentin e shpalljes fitues nga procesi i konkurrimit emërohen në funksionet organike, përfitojnë pagën për funksion të funksionit organik ku ata janë emëruar.

5. Klasat e pagave për nëpunësit civilë të Agjencisë janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementet përbërëse të secilës klasë page (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) dhe vlerat e çdo elementi janë sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës shtetërore.

6. Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për nëpunësit civilë të Agjencisë është sipas përcaktimit në kolonën 3, të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Klasat e pagave për pozicionet e punës të nëpunësve civilë me emërtesë të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së institucionit.

8. Nëpunësit civilë në pozicionet "specialist", "përgjegjës sektori" apo "drejtor drejtorie", që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të Agjencisë, përfitojnë shtesën përkatëse, sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës shtetërore.

9. Pagat e punonjësve administrativë/ mbështetës të Agjencisë përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike.

10. Pavarësisht kategorive të pagave të pozicioneve të nëpunësve civilë, të miratuara në strukturën dhe organikën ekzistuese të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re:

a) në rastet kur në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, klasa e pagës për të njëjtën emërtesë është e përcaktuar vetëm me një alternativë, do të zbatohet klasa e pagës, sipas përcaktimit në këtë lidhje;

b) në rastet kur për emërtesa të njëjta në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë përcaktuar më shumë sesa një klasë page, klasat që do të zbatohen janë, si më poshtë vijon:

i. Klasa IV-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-b;

ii. Klasa IV-2, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është IV-a;

iii. Klasa IV-3, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është IV-b.

11. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike të mbështesë dhe të sqarojë Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e klasave të pagave, deri në momentin e miratimit të strukturës dhe organikës së re.

12. Ngarkohet Agjencia e Mbikëqyrjes Policore të propozojë deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimin e strukturës dhe organikës ekzistuese për përshtatjen e saj, sipas klasave të pagave të përcaktuara në këtë vendim.

13. Vendimi nr. 487, datë 21.7.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore", shfuqizohet.

14. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**

| Nr. | Funksioni organik | Paga për funksion | Shtesa për natyrë të veçantë pune |
|---|---|---|---|
| | *1* | *2* | *3* |
| 1 | Ndihmësspecialist (vëzhgues/mbikëqyrës) në trupën operacionale. | 64 000 | 15 000 |
| 2 | Ndihmësspecialist (përpunues informacioni) në kartotekë. | 64 000 | 10 000 |
| 3 | Specialist në drejtoritë rajonale. | 85 000 | 15 000 |
| 4 | Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. | 91 000 | 12 000 |
| 5 | Specialist për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik (VETTING-un). | 91 000 | 20 000 |
| 6 | Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale. | 95000 | 17000 |
| 7 | Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme. | 102 000 | 15 000 |
| 8 | Përgjegjës sektori për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik (VETTING-un). | 102 000 | 20 000 |
| 9 | Titullar i drejtorisë rajonale. | 102 000 | 20 000 |
| 10 | Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. | 111 000 | 17 000 |
| 11 | Këshilltar i drejtorit të përgjithshëm. | 111 000 | 0 |
| 12 | Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. | 118 000 | 22 000 |
| 13 | Drejtor i përgjithshëm. | 128 500 | 30 000 |

**Lidhja nr. 2**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për nëpunësit civilë të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**

| Nr. | Pozicioni | Klasat e pagës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) |
|---|---|---|---|
| | *1* | *2* | *3* |
| 1 | Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme. | III-1 | 7 000 |
| 2 | Përgjegjës/shef sektori buxhet dhe financë në drejtorinë e përgjithshme. | III-2 | 5 000 |
| 3 | Përgjegjës/shef sektori në drejtorinë e përgjithshme. | III-2 | 0 |
| 4 | Specialist/zëdhënës shtypi në drejtorinë e përgjithshme. | IV-1 | 0 |
| | | IV-2 | 0 |
| 5 | Specialist në drejtoritë rajonale. | IV-2 | 0 |
| | | IV-3 | 0 |

## VENDIM
## Nr. 322, datë 31.5.2023

## PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave për nëpunësit dhe punonjësit administrativë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) për secilën klasë, të përcaktuara në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

3. Në kuptim të këtij vendimi:

a) drejtoritë e përmbajtjes apo sektorët e përmbajtjes janë ata/ato që realizojnë funksionet për të cilat është krijuar dhe funksionon institucioni. Në to nuk përfshihen strukturat organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) drejtoritë mbështetëse apo sektorët mbështetës janë ato/ata që kryejnë funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar" në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Pagat bazë për klasë dhe shtesat mbi pagë të punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës janë sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të administratës shtetërore.

7. Pavarësisht kategorive të pagave, të miratuara në strukturën dhe organikën ekzistuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re:

a) në rastet kur në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, klasa e pagës për të njëjtën emërtesë është e përcaktuar vetëm me një alternativë do të zbatohet klasa e pagës, sipas përcaktimit në lidhjet përkatëse të këtij vendimi;

b) në rastet kur për emërtesa të njëjta në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, janë përcaktuar më shumë sesa një klasë page, klasat që do të zbatohen janë, si më poshtë vijon:

i. Klasa IV-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-b;

ii. Klasa IV-2, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është IV-a.

8. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike të mbështesë dhe të sqarojë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e klasave të pagave, deri në momentin e miratimit të strukturës dhe organikës së re.

9. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës të propozojë, deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimin e strukturës dhe organikës ekzistuese për përshtatjen e saj, sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim.

10. Vendimi nr. 245, datë 24.4.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës", i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2023, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën".

12. Ngarkohet Agjencia Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-2 | 1 | 20 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit.<br>Drejtor Njësie. | I-4 | 1 | 20 000 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | II-1 | 1 | 20 000 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 | 20 000 |
| Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes. | III-1 | 1 | 18 000 |
| Përgjegjës i sektorëve mbështetës | III-2 | 1 | 18 000 |
| Përgjegjës sektori që lidhen me procesin e informatizimit. | III-1 | 1 | 50 000 |
| Koordinator. | III-2 | 1 | 18 000 |
| Specialist në pozicionet që lidhen me procesin e informatizimit. | IV-1 | 1 ose 2 | 60 000 |
| | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | |
| Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 | 18 000 |
| | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | |

**Lidhja nr. 2**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtoritë Vendore dhe Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë punës) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë. | III-1 | 1 | 20 000 |
| Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë. | III-2 | 1 | 18 000 |
| Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë. | III-2 | 1 | 18 000 |
| Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë. | IV-1 | 1 | 18 000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | III-2 | 1 | 18 000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | IV-1 | 1 | 18 000 |
| Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | IV-1 | 1 | 18 000 |
| Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë. | IV-2 | 1 | 18 000 |
| Titullar i Zyrës Vendore | III-3 | 1 | 18 000 |
| Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së parë. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 18 000 |
| Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë.<br>Specialist në zyrat vendore. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 18 000 |

Kategorizimi i drejtorive vendore është si vijon:

- Kategoria e parë: Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Vlorë, Fier, Kamzë – Vorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastër, Krujë, Lushnje, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës dhe Zonat e Stimuluara.
- Kategoria e dytë: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë dhe Tepelenë.

**VENDIM**
**Nr. 323, datë 31.5.2023**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË POZICIONEVE KOORDINATOR TË RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

1.1 Institucione të administratës shtetërore në nivel qendror, në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës, ku, për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të

Ushqimit, Drejtoria Qendrore e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Drejtoria Qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Instituti i Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

1.2 Institucione në nivel qendror të sistemit shëndetësor, ku, për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mretëresha Geraldinë", Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë, Spitali Psikiatik "Sadik Dinçi", Elbasan.

1.3 Institucione/degë rajonale/vendore të institucioneve të administratës shtetërore, ku për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

1.4 Institucione/degë rajonale vendore të sistemit shëndetësor, ku, për efekt të këtij vendimi, bëjnë pjesë: drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, spitalet rajonale.

2. Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikat 1.1. dhe 1.3., të këtij vendimi, janë përkatësisht, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore (paga për pozicionin, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) për secilën klasë, të përcaktuara në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

4. Paga bruto mujore për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikat 1.2. dhe 1.4., të këtij vendimi, është përkatësisht, sipas lidhjeve nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

5. Vlera e pagës së grupit dhe shtesa për vjetërsi, të përcaktuara në lidhjet nr. 3 dhe nr. 4, të këtij vendimi, kanë të njëjtën vlerë dhe mënyrë llogaritjeje me atë të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë më arsim të lartë në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

6. Pavarësisht kategorive të pagave të miratuara në strukturat dhe organikat ekzistuese të institucioneve, të përfshira në pikat 1.1. dhe 1.3., të këtij vendimi, deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re, për nëpunësit në pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit të këtyre institucioneve do të zbatohen klasat e përcaktuara në lidhjet nr.1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikat 1.1. dhe 1.3., të këtij vendimi, të propozojnë deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimin e strukturës dhe organikës ekzistuese për përshtatjen e saj, sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim.

8. Vendimi nr. 102, datë 16.2.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës e të niveleve të pagave të pozicioneve "koordinator" të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në disa institucione të administratës shtetërore", i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 të përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikën 1.1, të këtij vendimi**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Koordinator në:<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. | I-4 | 1 | 18 000 |
| Koordinator në:<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. | II-1 | 1 | 15 000 |
| Koordinator në:<br>- Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit;<br>- Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. | II-1 | 1 | 10 000 |
| Koordinator në:<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile;<br>- Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;<br>- Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;<br>- Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;<br>- Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;<br>- Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar;<br>- Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë;<br>- Agjencinë Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara;<br>- Autoritetin Rrugor Shqiptar në nivel qendror;<br>- Institutin e Shëndetit Publik;<br>- Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror;<br>- Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial;<br>- Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror. | II-1 | 1 | 5000 |
| Koordinator në:<br>- Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. | II-2 | 1 | 10 000 |

**Lidhja nr. 2**

**Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikën 1.3, të këtij vendimi**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Koordinator në:<br>- Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. | III-2 | 1 | 18 000 |
| Koordinator në:<br>- Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. | IV-1 | 1 | 18 000 |
| Koordinator në:<br>- Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar. | IV-1 | 1 | 5 000 |

*Shënim. Kategorizimi i drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e këtij institucioni.*

**Lidhja nr. 3**

**Paga bruto mujore për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikën 1.2, të këtij vendimi**

| Pozicioni | Paga bruto mujore | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Grupi i diplomës | Shtesa për vjetërsi | Shtesa e pozicionit | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
| Koordinator në:<br>- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". | 1 | 2% | 139 000 | 5 000 |
| Koordinator në:<br>- Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. | 1 | 2% | 130 000 | 5 000 |
| Koordinator në:<br>- Spitalin Obsetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë";<br>- Spitalin Universitar të Traumës;<br>- Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Koço Glozheni";<br>- Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi". | 1 | 2% | 126 000 | 5 000 |
| Koordinator në:<br>- Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. | 1 | 2% | 119 000 | 5 000 |
| Koordinator në:<br>- Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë;<br>- Spitalin Psikiatik "Sadik Dinci", Elbasan. | 1 | 2% | 102 000 | 5 000 |

**Lidhja nr. 4**

**Paga bruto mujore për pozicionet "koordinator", pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet e përcaktuara në pikën 1.4 të këtij vendimi**

| Pozicioni | Paga bruto mujore | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Grupi i diplomës | Shtesa për vjetërsi | Shtesa e pozicionit | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
| Koordinator në spitalet rajonale. | 1 | 2% | 102 000 | 5 000 |
| Koordinator në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. | 1 | 2% | 95 000 | 5 000 |

**VENDIM**
**Nr. 324, datë 31.5.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT SHQIPTAR TË MISIONEVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-s, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, SI DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS, SI OFICERË KONTAKTI, SI PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR BUJQËSINË DHE SI PROKUROR NDËRLIDHËS PRANË *EUROJUST* NË HAGË, HOLANDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të neneve 31, pika 2, dhe 53, pikat 1 e 3, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) punonjësit e personelit diplomatik të sistemit të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja;

b) punonjësit e personelit administrativo-teknik të sistemit të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja;

c) ushtarakët e Forcave të Armatosura, si dhe punonjësit civilë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes (vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar) për kohën që shërbejnë në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në stafin ndërkombëtar, stafin ushtarak ndërkombëtar, strukturën e komandës, strukturën e forcës, agjencitë dhe qendrat e NATO-s në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale;

ç) punonjësit e sistemit të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, të atashuar në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për kohën që shërbejnë si "oficerë kontakti" pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme;

d) punonjësit e sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel;

dh) punonjësit e ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financat, për kohën që shërbejnë si "nëpunës ndërlidhës", pranë qendrës SECI;

e) prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si "prokuror ndërlidhës" pranë *Eurojust* në Hagë, Holandë.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element për punonjësit e përcaktuar në shkronjat "a" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi, janë, si më poshtë vijon:

a) Paga bazë për gradë dhe apo funksion, e shprehur në dy monedhat kryesore, në euro apo në dollar amerikan, në varësi të vendit ku e ushtrojnë detyrën, sipas përcaktimit, përkatësisht, në lidhjet nr. 1 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Shtesa për koston e jetesës, që është shtesë që jepet në një vlerë të caktuar, në dy monedhat kryesore, në euro apo në dollar amerikan, bazuar në indeksin sipas nivelit të jetesës, sipas kategorizimit të vendit pritës, në masën e përcaktuar në pikën 15 të këtij vendimi.

3. I ngarkuari me punë në misionet diplomatike në vendet me të cilat kemi marrëdhënie në këtë nivel trajtohet në pagë me pagën e gradës "ministër këshilltar".

4. I ngarkuari me punë a.i., paguhet me një gradë më të lartë se ajo që mban për kohën që ushtron këtë funksion.

5. Paga e atasheut ushtarak nuk mund të jetë më e lartë se paga e punonjësit të personelit diplomatik me gradën "ministër këshilltar" në misionet diplomatike. Në rastet kur ministri i Mbrojtjes, në

marrëveshje me ministrin përgjegjës për punët e jashtme, për shkak të ngarkesës së punës, emëron edhe një ndihmës të atasheut ushtarak, paga e ndihmësit të atasheut ushtarak nuk mund të jetë më e lartë se paga e punonjësit të personelit diplomatik me gradën diplomatike "këshilltar" në misionet diplomatike.

6. Trajtimi me pagë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, për punonjësit e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, fillon nga data e mbërritjes në vendin e punës. Deri në këtë datë, punonjësit vazhdojnë të paguhen me pagën e vendit të mëparshëm të punës.

7. Punonjësit e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, kur shkojnë për herë të parë në vendin e punës, marrin si paradhënie një shumë në valutë, të barabartë me pagesën e 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, shumë që e shlyejnë brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e fillimit të detyrës. Nëse transferohen në atdhe përpara mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur e shlyejnë në monedhën kombëtare (lekë), sipas kursit të këmbimit valutor, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e kthimit në atdhe.

8. Paga bruto mujore e punonjësve, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi, e shprehur në dy monedhat kryesore, në euro apo në dollar amerikan, në varësi të vendit ku e ushtrojnë detyrën, është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Edhe në rastet kur në këto pozicione punësohen shtetas të vendit ku ndodhet misioni diplomatik, ata trajtohen me pagë në të njëjtën masë si punonjësit shqiptarë.

9. Kufijtë e pagës bruto mujore të punonjësve, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi, në rastet kur këta punonjës janë të punësuar me kohë të pjesshme, janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Aplikimi i kufirit maksimal apo minimal të pagës përcaktohet në varësi të ngarkesës së punës, me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

10. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element të punonjësve, të përcaktuar në shkronjat "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij vendimi janë, si më poshtë vijon:

a) Paga bazë mujore e pozicionit të punës, e shprehur në dy monedhat kryesore, në euro apo në dollar amerikan, në varësi të vendit ku e ushtrojnë detyrën, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, duke njësuar atë me pagën bazë për gradë/pozicion të punonjësit të personelit diplomatik me gradën diplomatike "këshilltar" në misionet diplomatike.

b) Shtesa për koston e jetesës, që është shtesë që jepet në një vlerë të caktuar, në dy monedhat kryesore, në euro apo në dollar amerikan, bazuar në indeksin sipas nivelit të jetesës, sipas kategorizimit të vendit pritës, si më poshtë vijon:

i. në masën e përcaktuar në pikën 15, të këtij vendimi, për punonjësit e përcaktuar në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi;

ii. në masën 180 (njëqind e tetëdhjetë) euro në muaj, për punonjësit e përcaktuar në shkronjën "dh", të pikës 1, të këtij vendimi.

11. Trajtimi me pagë, sipas këtij vendimi, për punonjësit e përcaktuar në shkronjat "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, fillon përkatësisht, nga data e mbërritjes së tyre në misionin diplomatik apo pranë qendrës SECI. Deri në këtë datë, ata trajtohen me pagën e vendit të mëparshëm të punës.

12. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, të përcaktuar në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij vendimi, janë si më poshtë vijon:

a) Paga bazë mujore, që është paga mujore bruto e pozicionit që prokurori ka mbajtur në momentin e komandimit si "prokuror ndërlidhës";

b) Shtesa në masën 40 (dyzet) %, që llogaritet mbi pagën bazë mujore, të përcaktuar sipas shkronjës "a", të kësaj pike.

13. Punonjësit e përcaktuar në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij vendimi, përveç pagës bruto mujore, të përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, përfitojnë edhe kompensimin për koston e jetesës, në masën 280 (dyqind e tetëdhjetë) euro në muaj.

14. Trajtimi me pagë dhe kompensim për koston e jetesës, sipas këtij vendimi, për punonjësit e përcaktuar në shkronjën "e", të pikës 1, fillon nga data e fillimit të detyrës së tij pranë *Eurojust.*

15. Masa e shtesës për koston e jetesës për punonjësit e përcaktuar në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi, është si më poshtë vijon:

| Nr. rendor | Klasifikimi i vendeve | Kompensimi (euro/dollar amerikan/muaj) |
|---|---|---|
| 1 | Për vendet e grupit të parë | 360 euro/USD |
| 2 | Për vendet e grupit të dytë | 320 euro/USD |
| 3 | Për vendet e grupit të tretë | 280 euro/USD |
| 4 | Për vendet e grupit të katërt | 240 euro/USD |
| 5 | Për vendet e grupit të pestë | 180 euro/USD |

16. Grupimi i vendeve, për efekt të përfitimit të shtesës për koston e jetesës, për:

a) punonjësit e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) punonjësit e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) punonjësit e përcaktuar në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Punonjësit e personelit diplomatik, të cilët shërbejnë në misionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në *New York*, për një periudhë dyvjeçare të anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit, për periudhën deri më 15 janar 2024, përfitojnë një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Paga mujore bruto e punonjësve, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të saj do të paguhen edhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

19. Vendimi nr. 546, datë 11.8.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të punonjësve të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel dhe prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë *Eurojust* në Hagë, Holandë", i ndryshuar, shfuqizohet.

20. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 të përballohen:

a) për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, nga fondet e akorduara për këtë ministri, për këtë vit;

b) për institucionet e tjera, nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

21. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Paga bazë për gradë/funksion e punonjësve të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi**

| Pozicioni/grada | Paga bazë për gradë/funksion (në euro) | Paga bazë për gradë/funksion (në dollar USD) |
|---|---|---|
| Ambasador | 3 530 | 4 300 |
| Konsull i Përgjithshëm. | 2 730 | 3 290 |
| Ministër Fuqiplotë.<br>Ministër Këshilltar. | 2 180 | 2 630 |
| Këshilltar. | 1 820 | 2 310 |
| Sekretar i Parë.<br>Konsull. | 1 540 | 1 840 |
| Sekretar i Dytë.<br>Zëvendëskonsull. | 1 190 | 1 500 |
| Sekretar i Tretë.<br>Agjent Konsull. | 1 075 | 1 310 |
| Atashe. | 960 | 1 180 |

**Lidhja nr. 2**

**Paga bruto mujore e punonjësve të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi (në rastin kur janë të punësuar me kohë të plotë)**

| Pozicioni | Paga bruto mujore (në euro) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Grupi 1 | Grupi 2 | Grupi 3 | Grupi 4 | Grupi 5 |
| Sekretar teknik.<br>Financier. Specialist. | 1 330 | 1 270 | 1 210 | 1 170 | 1 090 |
| | Paga bruto mujore (në dollar USD) | | | | |
| | 1 490 | 1 430 | 1 380 | 1 340 | 1 270 |
| | | | | | |
| Shofer. | Paga bruto mujore (në euro) | | | | |
| | 1 270 | 1 200 | 1 140 | 1 100 | 1 020 |
| | Paga bruto mujore (në dollar USD) | | | | |
| | 1 430 | 1 360 | 1 300 | 1 280 | 1 190 |
| | | | | | |
| Kafaz | Paga bruto mujore (në euro) | | | | |
| | 1 050 | 1 000 | 950 | 900 | 840 |
| | Paga bruto mujore (në dollar USD) | | | | |
| | 1 160 | 1 110 | 1 060 | 1 020 | 940 |

**Lidhja nr. 3**

## Kufijtë e pagës bruto mujore të punonjësve të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi (në rastin kur janë të punësuar me kohë të pjesshme)

| Pozicioni | Paga bruto mujore | |
|---|---|---|
| | **Kufiri minimal** | **Kufiri maksimal** |
| Sekretar teknik.<br>Financier.<br>Specialist. | | **Në euro** |
| | 480 | 750 |
| | | **Në dollar USD** |
| | 530 | 820 |
| Punonjës pastrimi. | | **Në euro** |
| | 380 | 500 |
| | | **Në dollar USD** |
| | 400 | 550 |

**Lidhja nr. 4**

## Paga bazë për gradë e punonjësve të përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi

| Grada | Paga bazë (në euro) | Paga bazë (në dollar USD) |
|---|---|---|
| **Përfaqësitë e NATO-s** | | |
| Gj. lejtnant | 3 300 | 3 990 |
| Gj. major | 3 235 | 3 850 |
| Gj. brigade | 3 025 | 3 625 |
| **Përfaqësitë e tjera** | | |
| Kolonel | 2 480 | 3 040 |
| Nënkolonel | 2 365 | 2 835 |
| Major | 1 960 | 2 340 |
| Kapiten | 1 820 | 2 310 |
| Toger | 1 715 | 2 100 |
| Nëntoger | 1 590 | 1 975 |
| K/kapter | 1 715 | 2 100 |
| Kapter | 1 540 | 1 860 |
| Rreshter | 1 315 | 1 540 |
| Tetar | 1 075 | 1 305 |
| Nëntetar | 960 | 1 180 |

**Lidhja nr. 5**

## Paga bazë mujore e punonjësve të përcaktuar në shkronjat "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij vendimi

| Emërtimi | Paga bazë mujore e pozicionit (në euro) | Paga bazë mujore e pozicionit (në dollar USD) |
|---|---|---|
| | | |
| Oficer kontakti.<br>Përfaqësues të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural. | 1 820 | 2 310 |
| Nëpunës ndërlidhës. | 1 820 | |

**Lidhja nr. 6**

## Grupimi i vendeve për efekt të përfitimit të shtesës për koston e jetesës për punonjësit e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi

| Grupi 1 | Grupi 2 | Grupi 3 | Grupi 4 | Grupi 5 |
|---|---|---|---|---|
| 1. Misoni NY<br>2. Londër<br>3. Gjenevë<br>4. Kopenhagen<br>5. Bernë<br>6. Moskë<br>7. Pekin<br>8. Tokio<br>9. Milano<br>10. Stamboll<br>11. Kambera | 1. Vjenë<br>2. Misioni OSBE<br>3. Uashington<br>4. Paris<br>5. Romë<br>6. Strasburg<br>7. Berlin<br>8. Madrid<br>9. Otava<br>10. UNESCO<br>11. Vatikan<br>12. Brazil<br>13. Mynih | 1. Bruksel<br>2. Nato<br>3. Athinë<br>4. Ankara<br>5. Hagë<br>6. Stokholm<br>7. Varshavë<br>8. Budapest<br>9. Pragë<br>10. Beograd<br>11. Selanik<br>12. Tel-Aviv<br>13. Bratislavë<br>14. Lubjanë<br>15. Kiev | 1. Zagreb<br>2. Kajro<br>3. Janinë<br>4. Bari<br>5. Riad<br>6. Katar<br>7. Kuvajt<br>8. EBA | 1. Shkup<br>2. Prishtinë<br>3. Sofje<br>4. Podgoricë<br>5. Bukuresht |

**Lidhja nr. 7**

## Grupimi i vendeve për efekt të përfitimit të shtesës për koston e jetesës për punonjësit e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi

| Grupi 1 | Grupi 2 | Grupi 3 | Grupi 4 | Grupi 5 |
|---|---|---|---|---|
| 1. Londër<br>2. Gjenevë<br>3. Moskë<br>4. Stamboll<br>5. Milano<br>6. Nortfolk - Virginia | 1. Vjenë<br>2. Uashington<br>3. Paris<br>4. Romë<br>5. Berlin<br>6. Madrid<br>7. Napoli<br>8. Oberamergau<br>9. Brunsum<br>10. Florida SHBA<br>11. Wiesbaden<br>12. Ramstein<br>13. Lile<br>14. Talin<br>15. Ferrara (Bolonjë) | 1. Bruksel<br>2. Nato<br>3. Athinë<br>4. Ankara<br>5. Hagë<br>6. Stokholm<br>7. Varshavë<br>8. Budapest<br>9. Mons<br>10. Selanik | 1. Zagreb<br>2. Izmir | 1. Shkup<br>2. Bukuresht<br>3. Sofje<br>4. Kumanovë<br>5. Sarajevë |

**Lidhja nr. 8**

## Grupimi i vendeve për efekt të përfitimit të shtesës për koston e jetesës për punonjësit e përcaktuar në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij vendimi

| Grupi 1 | Grupi 2 | Grupi 3 | Grupi 4 | Grupi 5 |
|---|---|---|---|---|
| 1. Londër<br>2. Gjenevë<br>3. Kopenhagën<br>4. Berne<br>5. Moskë<br>6. Pekin<br>7. Tokio<br>8. Milano<br>9. Stamboll | 1. Vjenë<br>2. Uashington<br>3. Paris<br>4. Romë<br>5. Strasburg<br>6. Berlin<br>7. Madrid<br>8. Otava | 1. Bruksel<br>2. Nato<br>3. Athinë<br>4. Ankara<br>5. Hagë<br>6. Stokholm<br>7. Varshavë<br>8. Budapest<br>9. Pragë<br>10. Beograd<br>11. Selanik<br>12. Tel-Aviv<br>13. EUROPOL | 1. Zagreb<br>2. Kajro<br>3. Janinë<br>4. Bari<br>5. K. Lumpur<br>6. Riad | 1. Shkup<br>2. Prishtinë<br>3. Sofje<br>4. Podgoricë<br>5. Buenos Aires<br>6. Bukuresht |

**Lidhja nr. 9**

**Masa e shpërblimit mujor për çdo pozicion të personelit të shërbimit diplomatik, në misionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë, pranë OKB-së, në *New York*, për periudhën deri më 15 janar 2024**

| | Pozicioni/grada | Shpërblimi mujor në vlerë (në dollar USD) |
|---|---|---|
| 1 | Ambasador | 1 230 |
| 2 | Ministër Fuqiplotë<br>Ministër Këshilltar | 940 |
| 3 | Këshilltar | 830 |
| 4 | Sekretar i Parë | 660 |
| 5 | Sekretar i Dytë | 540 |
| 6 | Sekretar i Tretë | 470 |
| 7 | Atashe | 420 |

**VENDIM**
**Nr. 325, datë 31.5.2023**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"; të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen zëvendësministrat, funksionarët e kabineteve, prefekti, nënprefekti, nëpunësit civilë dhe nëpunësit (subjekte përfituese) në institucionet, si më poshtë vijon:

a) Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, administratën e Kuvendit, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Institutin për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, Gjykatën e Lartë, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisionin e Prokurimit Publik, Institutin e Statistikave, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, administratën e Shkollës së Magjistraturës, Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë;

b) Institucionet qendrore të grupit të parë, ku bëjnë pjesë: Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia e

Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencia për Media dhe Informim, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Avokatura e Shtetit;

c) Institucionet qendrore të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë: Agjencia Telegrafike Shqiptare, Inspektorati Qendror, Komiteti për Pakicat Kombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

ç) Institucionet qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, Komiteti Shtetëror i Kulteve, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia për Efiçencën e Energjisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, Autoriteti Rregullator Hekurudhor, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve, Incidenteve Hekurudhore dhe Detare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësim, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Shifrës, Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;

d) Institucionet qendrore të grupit të katërt, ku bëjnë pjesë: Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, Agjencia Kombëtare e Rinisë, administrata e prefektit, Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, Qendra e Pritjes për Azil, Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme, Durrës, Qendra e Botimeve Zyrtare, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Agjencia Kombëtare e Falimentimit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, Agjencia e Sigurimit

të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Agjencia e Shërbimeve të Sportit Tiranë, qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, Instituti i Studimeve të Transportit, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Cirku Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi", Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit Sarandë, zyrat e administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike, Qendra Muzeore Krujë – Muzeu Kombëtar "Skënderbeu"- Muzeu Etnografik Krujë, Qendra Muzeore Berat – Muzeu i Ikonografisë "Onufri", Muzeu Etnografik Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Qendra Muzeore Durrës, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Komanda dhe Shtabi i Forcës Tokësore, Komanda dhe Shtabi i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, Komanda dhe Shtabi i Forcës Ajrore, Komanda dhe Shtabi i Komandës Mbështetëse, Qendra e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Instituti Kërkimor-Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit, në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, Sektori i Helikopterëve i Repartit Special RENEA, shtëpitë e pushimit të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, batalionet/kompanitë/qendrat stërvitore në Forcën Tokësore, distriktet detare/flotiljet detare/Shërbimi Hidrografik/Qendra e Vëzhgimit Detar/Qendra e Zhytjeve/Qendra Stërvitore/kompanitë mbështetëse në Forcën Detare, Baza Ajrore/ Shërbimi Meteorologjik Ushtarak/Qendra e Kontroll-Raportimit/Qendra Stërvitore/ Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/ Kompani / Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/ Qendra në Akademinë e Forcave të Armatosura;

dh) Degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "d", të kësaj pike.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

a) Njësitë organizative të përmbajtjes, drejtoritë e përgjithshme të përmbajtjes, drejtoritë e përmbajtjes apo sektorët e përmbajtjes janë ata/ato që realizojnë funksionet për të cilat është krijuar dhe funksionon institucioni. Në to nuk përfshihen strukturat organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) Njësitë organizative mbështetëse, drejtoritë e përgjithshme mbështetëse, drejtoritë mbështetëse, sektorët mbështetës apo specialistët mbështetës janë ato/ata që kryejnë funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

II. KATEGORITË, KLASAT DHE ELEMENTET PËRBËRËSE TË PAGËS BRUTO MUJORE

1. Kategoritë, klasat e pozicioneve të punës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element të tyre për funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, me përjashtim të nëpunësve të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, janë, si më poshtë vijon:

a) Kategoritë dhe klasat e pozicioneve të punës përcaktohen në kolonat 1 dhe 2, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, është sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 1;

c) Shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjes nr. 1 dhe në lidhjet përkatëse të këtij vendimi. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

d) Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

dh) Shtesa për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin.

Klasat e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së secilit institucion.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore janë, si më poshtë vijon:

a) Për funksionarët në pozicionet zëvendësministër, prefekt, nënprefekt, këshilltar i Prefektit të Qarkut Tiranë dhe zëdhënës i Prefektit të Qarkut Tiranë, paga bazë mujore e pozicionit të punës;

b) Për nëpunësit kërkimorë-shkencorë të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, paga bazë mujore e pozicionit të punës, e përcaktuar sipas titullit akademik apo gradës shkencore.;

c) Për nëpunësit e trupës artistike në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, trupës artistike në Teatrin Kombëtar, trupës artistike në Teatrin e Kukullave në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, trupës artistike në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", trupës artistike në Cirkun Kombëtar, trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medies dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe trupës artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij kreu;

iii. shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

ç) Për nëpunësit e sektorit të helikopterëve në Repartin Special RENEA:

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij kreu;

iii. shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

d) Për nëpunësit në pozicionet "sekretar":

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij kreu;

dh) Për nëpunësit në pozicionet "ekspertë" në qendrat e ekselencës, paga bazë mujore e pozicionit të punës.

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, "vite pune" do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

4. Masa e shtesës për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për disa nga funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, në masën dhe sipas rregullave e kritereve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. KLASAT DHE NIVELET E PAGAVE E TË PAGESAVE TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE

1. Klasat e pagave për funksionarët e kabineteve të institucioneve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, dhe vlera e pagës bazë mujore për pozicionet "zëvendësministër", "prefekt", "nënprefekt" dhe "sekretar" janë sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Presidenti i Republikës, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat apo titullarët e institucioneve në varësi të tyre, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të misionit dhe objektivave të institucionit, që drejtojnë, kanë të drejtë që, për të marrë këshillimin e duhur për çështje specifike, të kenë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm. Pagesa e këshilltarëve të jashtëm dhe ndihmësve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike e përcaktuar sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat dhe përcaktohet nga:

a) Presidenti, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj;

b) Kryeministri, për këshilltarët e jashtëm dhe ndihmësit e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën përkatësisht deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj për këshilltarët e jashtëm dhe deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj për ndihmësit e jashtëm;

c) Zëvendëskryeministri dhe ministrat, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj;

ç) Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Përjashtimisht, Kryeministri ka të drejtë të angazhojë si këshilltarë të jashtëm edhe shtetas të huaj, ekspertë/konsulentë të njohur ndërkombëtarisht, me një pagesë jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë në muaj, për një periudhë angazhimi jo më shumë sesa kohëzgjatja e mandatit të tij.

4. Paga bazë mujore e nëpunësve në pozicionet "ekspertë", në qendrat e ekselencës, pjesë e strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, është, si më poshtë vijon:

a) Në Kryeministri dhe aparatet e ministrive:

i. Ekspert i kategorisë së parë, 153 000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë në muaj;

ii. Ekspert i kategorisë së dytë, 129 000 (njëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë në muaj.

b) Në institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave:

i. Ekspert i kategorisë së parë, 129 000 (njëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë në muaj;

ii. Ekspert i kategorisë së dytë, 109 000 (njëqind e nëntë mijë) lekë në muaj.

5. Klasat e pagave për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/1. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm janë sipas lidhjes nr. 7/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/2. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr. 7/2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr. 7/2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/3. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë sipas lidhjes nr. 7/3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë sipas lidhjes nr. 7/3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/4. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 7/4/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 7/4/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/5. Klasat e pagave për pozicionet e punës në Shkollën e Magjistraturës janë sipas lidhjes nr. 7/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë sipas lidhjes nr. 8/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor janë sipas lidhjes nr. 8/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/3. Klasat e pagave për pozicionet e punës në administratën e Avokaturës së Shtetit janë sipas lidhjes nr. 8/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit në pozicionin "Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.

8. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Inspektoratin Qendror janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave janë sipas lidhjes nr. 9/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/3. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit doganor janë sipas lidhjes nr. 9/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit/punonjësit e kategorizuar në kategoritë C3, D1, D2 dhe D3, të lidhjes nr. 9/3, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë, në masën 1% mbi pagën e pozicionit pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.

8/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit tatimor janë sipas lidhjes nr. 9/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë sipas lidhjes nr. 9/5,

që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/1. Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët janë sipas lidhjes nr. 10/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Agjencinë e Trajtimit të Pronës janë sipas lidhjes nr. 10/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/3. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë sipas lidhjes nr. 10/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Akademinë e Forcave të Armatosura, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë sipas lidhjes nr. 10/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe vështirësi shërbimi për pozicionet civile të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "zëvendësdrejtor i përgjithshëm" në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 10/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pozicionet në funksione operacionale, operacionale mbështetëse, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së kësaj agjencie.

9/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar i institucionit" në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë janë sipas lidhjes nr. 10/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/7. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar i institucionit" në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor janë sipas lidhjes nr. 10/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/8. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve pa tituj akademikë në pozicionet e punës "specialist" deri në "titullar i institucionit" në Institutin e Shëndetit Publik janë sipas lidhjes nr. 10/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/9. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar dhe në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor janë sipas lidhjes nr. 10/9 (pjesët I, II dhe III), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike të Teatrit të Kukullave në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" dhe të Cirkut Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 11/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/2. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura janë sipas lidhjes nr. 11/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/3. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" (punonjës civilë) në institucionet e tjera të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1, të kreut I, përjashtuar Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, janë sipas lidhjes nr. 11/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/4. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Sekretar i Përgjithshëm" në administratën e prefektit janë sipas lidhjes nr. 11/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/5. Vlera e pagës bazë mujore për pozicionin e punës dhe shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) në sektorin e helikopterëve të Repartit Special RENEA janë sipas lidhjes nr. 11/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Klasat e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "titullar institucioni", në degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "d", të pikës 1, të kreut I, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse "specialist", "shef seksioni" dhe "përgjegjës/shef sektori", në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura, janë sipas lidhjes nr. 12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Inspektorët veterinarë kufitarë, inspektorët fitosanitarë kufitarë dhe inspektorët e shërbimit të inspektoratit ushqimor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, të cilët bëjnë pjesë në grupet e kontrollit doganor, paguhen me klasën IV-2.

11/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë sipas lidhjes nr. 12/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në komisionet vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut, janë sipas lidhjes nr. 12/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/3. Klasat e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse "specialist", "shef seksioni" dhe "përgjegjës/shef sektori" në drejtoritë e policisë në qarqe, komisariate dhe reparte autonome janë sipas lidhjes nr. 12/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/4. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar i qendrës" në qendrat e mbrojtjes civile në qark janë sipas lidhjes nr. 12/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar i degës" në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë sipas lidhjes nr. 12/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar i zyrës përmbarimore vendore" në zyrat përmbarimore vendore të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror janë sipas lidhjes nr. 12/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Punonjësit e projekteve, me tituj "Projekte me KfW", "Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe", "Projekti i shërbimeve esenciale", në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës–Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në përfundimin e projektit përkatës të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:

a) drejtues projekti (koordinator): klasa I-4;

b) specialist: klasa IV-1.

2. Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI – Shqipëri), të cilët, sipas organizimit të mëparshëm, kanë pasur emërtesën "koordinator" dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.

3. Pagat e punonjësve administrativë të institucioneve të përfshira në fushën e veprimit të këtij vendimi përcaktohen, në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës.

4. Pavarësisht kategorive të pagave të miratuara në strukturat dhe organikat ekzistuese të institucioneve, deri në miratimin e strukturave dhe organikave të reja:

a) në rastet kur në lidhjen/lidhjet që përcakton/përcaktojnë klasifikimin e pagave të institucionit, klasa e pagës për të njëjtën emërtesë është e përcaktuar vetëm me një alternativë, do të zbatohet klasa e pagës sipas përcaktimit në lidhjen/lidhjet përkatëse të këtij vendimi;

b) në rastet kur për emërtesa të njëjta në lidhjen/lidhjet, që përcakton/përcaktojnë klasifikimin e pagave të institucionit, janë përcaktuar më shumë sesa një klasë page, klasat që do të zbatohen janë si më poshtë vijon:

i. klasa II-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është II-b;

ii. klasa III-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-a;

iii. klasa III-2, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-a/1;

iv. klasa III-3, nëse kategoria e pagës për pozicionet "përgjegjës/shef sektori" në organikën ekzistuese është III-b;

v. përkatësisht klasat III-2 ose III-3, nëse kategoritë e pagave për pozicionet përgjegjës/shef sektori/zyre në organikën ekzistuese të administratës së prefektit janë përkatësisht III-b ose IV-a;

vi. përkatësisht klasat IV-1, IV-2, IV-3 ose IV-4, për të gjitha rastet e tjera, përjashtuar sa është përcaktuar më sipër në këtë pikë, nëse kategoritë e pagave në organikat ekzistuese janë, përkatësisht, III-b, IV-a, IV-b ose IV-c.

5. Vendimi nr. 187, datë 8.3.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen:

a) Departamenti i Administratës Publike të mbështesë dhe të sqarojë institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e klasave të pagave deri në momentin e miratimit të strukturave dhe organikave të reja;

b) institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim;

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxjerrë udhëzimin përkatës për llogaritjen e pagës mujore bruto, në zbatim të këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen:

a) për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, nga fondet e akorduara për këtë ministri, për këtë vit;

b) për institucionet e tjera, nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Kategoritë e klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikën 2, të kreut II**

| Kategoria | | Klasa e pagës (pozicioneve të punës për secilën kategori) | Elementet e pagës bruto mujore, përjashtuar shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që jepen rast pas rasti sipas përcaktimit në këtë vendim | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga për pozicion (lekë në muaj) | Shtesa e nivelit të kualifikimit | Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes së përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut II) |
| *1* | | *2* | *3* | *4* | *5* |
| E lartë drejtuese | I | I-1 | 235 000 | 1 | |
| | | I-2 | 217 000 | 1 | |
| | | I-3 | 205 000 | 1 | |
| | | I-4 | 180 000 | 1 | |
| | | I-5 | 170 000 | 1 | |
| E mesme drejtuese | II | II-1 | 155 000 | 1 | |
| | | II-2 | 141 000 | 1 | |
| E ulët drejtuese | III | III-1 | 115 000 | 1 | |
| | | III-2 | 105 000 | 1 | |
| | | III-3 | 95 000 | 1 | |
| Ekzekutive | IV | IV-1 | 80 000 | 1 ose 2 | |
| | | IV-2 | 70 000 | 1 ose 2, ose 3 | |
| | | IV-3 | 60 000 | 1 ose 2, ose 3 | |
| | | IV-4 | 50 000 | 1 ose 2, ose 3 | |

**Lidhja nr. 2**

**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit**

| Grupi i diplomës | Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) | Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj) |
|---|---|---|
| 1 | Niveli 7 i KSHK<br>(Master i shkencave.<br>Master i arteve.<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 14 000 |
| 2 | Niveli 7 i KSHK-së<br>(Master profesional.<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 12 000 |
| 3 | Niveli 6 i KSHK-së<br>(Bachelor.<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 10 000 |

**Lidhja nr. 3**

**Masa e shtesës për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për disa nga funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të vendimit**

1. Në administratën e Presidentit dhe të Kuvendit nëpunësit/funksionarët në pozicionet "Sekretar i Përgjithshëm", "Drejtor i kabinetit të Presidentit" dhe "Drejtor i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit", në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj.

2. Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nëpunësi në pozicionin "Sekretar i Përgjithshëm" në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe nëpunësit në pozicionet "inspektor i lartë" e "ndihmësinspektor i lartë", në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

3. Në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4. Në Qendrën për Teknologjinë e Informacionit për sistemin e Drejtësisë, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionin "Drejtor ekzekutiv" dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "specialist".

5. Në Kryeministri:

a) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit/funksionarët në pozicionet "Sekretar i Përgjithshëm", "Drejtor i kabinetit të Kryeministrit", ;

b) në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit/funksionarët në pozicionin "Drejtor i kabinetit të Zëvendëskryeministrit" dhe "drejtor departamenti" në departamentet përgjegjëse për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave, për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen;

c) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. "drejtor njësie", në departamentet përgjegjëse për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave, për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen;

ii. "drejtor drejtorie" në departamentet përgjegjëse për politikat, integrimin dhe mirëqeverisjen, dhe për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave;

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "jurist" dhe "koordinator", në departamentet përgjegjëse për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave dhe aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "koordinator", në departamentin përgjegjës për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen dhe përgjegjës i sektorit që mbulon buxhetin dhe financën;

ç) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit/funksionarët në pozicionet:

i. "këshilltar" në kabinetin e Kryeministrit dhe të Zëvendëskryeministrit;

ii. "drejtor departamenti", në departamentin përgjegjës për administrimin;

iii. "drejtor njësie" në njësinë përgjegjëse për buxhetin dhe administrimin;

iv. "drejtor drejtorie" me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar;

v. "koordinator" në njësinë e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm;

vi. "drejtor drejtorie", "përgjegjës sektori" dhe "specialist" në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave.

6. Në ministritë e linjës:

i. në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "Sekretar i Përgjithshëm";

ii. në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "drejtor drejtorie" me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.

7. Në ministrinë përgjegjëse për financat:

a) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet:

i. "Drejtor i Përgjithshëm" në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikat fiskale, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë dhe në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin;

ii. "Drejtor drejtorie", në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikat fiskale, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator;

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionet:

i. "përgjegjës sektori" në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. "përgjegjës sektori" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikat fiskale dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. "koordinator" dhe "specialist" në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit,

ii. "specialist" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikat fiskale dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator;

d) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në njësitë e tjera organizative të përmbajtjes.

8. Në Ministrinë e Drejtësisë:

a) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin "drejtor i përgjithshëm" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe për nëpunësit në pozicionet "drejtor drejtorie", në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit;

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "përgjegjës sektori" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "koordinator" dhe "specialist" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit.

9. Në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, nëpunësit në pozicionet "titullar i institucionit", nëpunësit në zyrën e koordinimit dhe në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

10. Në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, "titullari i institucionit" dhe nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

11. Në Agjencinë e Prokurimit Publik, nëpunësi në pozicionin "titullar institucioni" dhe nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

12. Në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje nëpunësit në:

a) pozicionet "titullar institucioni" dhe "drejtor drejtorie" të drejtorive të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj;

b) nëpunësit në pozicionet "koordinator" të atashuar pranë Kryeministrisë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

13. Në Departamentin e Administratës Publike:

a) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "drejtor njësie" dhe "drejtor drejtorie", të njësive organizative të përmbajtjes,

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionin "drejtor departamenti";

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "përgjegjës sektori", "koordinator" dhe "specialist", në njësitë organizative të përmbajtjes.

14. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave:

a) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin "përgjegjës i sektorit të gjuhëve të rralla";

b) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "specialist të

gjuhëve të rralla" (osmanolog, bizantolog dhe latinolog).

15. Në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve:

a) nëpunësi në pozicionin "titullar i institucionit", në masën 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

16. Në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit:

a) nëpunësi në pozicionin "titullar i institucionit", në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

17. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, nëpunësit e njësisë së ekzaminimit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

18. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, "titullari i institucionit", nëpunësit në pozicionin "menaxher cilësie" dhe nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

19. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, nëpunësit në pozicionet:

a) titullar institucioni, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

b) drejtues i degëve territoriale të Shërbimit të Provës, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj;

c) specialistë të përmbajtjes në degët territoriale të Shërbimit të Provës, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

20. Në Institutin e Mjekësisë Ligjore nëpunësit në pozicionet Ekspert Mjeko–Ligjor, Ekspert Antropolog Ligjor, Ekspert Toksikologo–Ligjor, Ekspert Psikiatër–Ligjor, Ekspert Biologo–Ligjor, Ekspert Mjeko–Ligjor pranë gjykatave të apelit dhe Ekspert Anatomo-Patolog pranë gjykatave të apelit, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

21. Në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nëpunësit në pozicionet "titullar i institucionit" dhe "administrator", në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

22. Në Drejtorinë e Shifrës, nëpunësit në pozicionet "përgjegjës sektori" dhe "specialist", në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

23. Në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake nëpunësit në pozicionin "titullar i institucionit" dhe nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

24. Në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionin "drejtor drejtorie", nëse funksioni i auditimit të brendshëm të institucionit është i organizuar në nivel drejtorie dhe për nëpunësin në pozicionin "përgjegjës sektori", nëse ky funksion është i organizuar në nivel sektori.

25. "Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit", "Drejtorët e drejtorive" apo "Drejtorët e Përgjithshëm" që zotërojnë diplomë universitare të nivelit "Master i Shkencave/Master Profesional/Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri Elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni", "Teknologji Informacioni", "Informatikë ekonomike" "Informatikë biznesi", "Inxhinieri matematike informatike", "Shkenca kompjuterike", "Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)" dhe që punojnë në pozicione IT që nuk janë përgjegjëse për zhvillimin apo ndjekjen e mirëmbajtjes së bazave të të dhënave shtetërore të miratuara e të regjistruara si të tilla pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, në masën përkatësisht:

a) 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave TIK, të institucioneve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "d", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi;

b) 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve të përcaktuara në shkronjën "dh", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Përjashtohen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Qendrës së Teknologjisë për

Sistemin e Drejtësisë dhe nëpunësve që përfshihen në pikën 26, të kësaj lidhjeje.

Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhin ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat.

Përjashtimisht, nëpunësit në pozicione IT të institucioneve të përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, që deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë përfituar shtesën në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj sipas përcaktimit të pikës 4/1, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, do të vijojnë të përfitojnë shtesën në të njëjtën masë deri në kalimin e këtyre pozicioneve pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

26. "Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit", "Drejtorët e drejtorive" apo "Drejtorët e Përgjithshëm" që zotërojnë diplomë universitare të nivelit "Master i Shkencave/Master Profesional/ Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri Elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni", "Teknologji Informacioni", "Informatikë ekonomike" "Informatikë biznesi", "Inxhinieri matematike informatike", "Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)", "Shkenca kompjuterike" dhe që punojnë në: i. pozicione IT që janë përgjegjëse për zhvillimin apo ndjekjen e mirëmbajtjes së bazave të të dhënave shtetërore të miratuara e të regjistruara si të tilla pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe; ii. pozicione IT përgjegjës për sistemet informatike në administratën e Kuvendit, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe drejtorisë përgjegjëse për fushën TIK në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, në masën përkatësisht:

- 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "specialist";
- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "përgjegjës sektori";
- 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "drejtor drejtorie" apo "drejtor i përgjithshëm".

Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhin ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat.

**Lidhja nr. 4**

**Nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar që përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin në masën dhe sipas rregullave e kritereve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave**

Nëpunësit civilë dhe nëpunësit e institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi që përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, janë si vijon:

a) në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës - "përgjegjës i sektorit të arkivit" dhe "specialist arkivi";

b) në njësitë organizative të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit - "përgjegjës sektori" dhe "specialist";

c) në sektorin përgjegjës për arkivin në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit - "përgjegjës sektori" dhe "specialist arkivi";

ç) në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar - "përgjegjës sektori" dhe "specialist" në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë;

d) në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial - "përgjegjës sektori" dhe "laborant" në laboratorët e naftës e të gazit dhe laboratorët e lëkurë - tekstileve, si dhe "inspektor" të naftës dhe gazit në doganë, autobot, cisternë dhe depozitë tokësore;

dh) në drejtorinë e laboratorit doganor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - "drejtor drejtorie", "përgjegjës sektori", "specialist/ laborant", "asistent laborant" dhe "magazinier në laborator";

e) në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura - nëpunësit e laboratorit;

ë) në Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar - nëpunësit e laboratorit;

f) në Laboratorin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit - nëpunësit e laboratorit;

g) në Kryeministri - "Stenograf, regjistrues audio",;

gj) në Kuvendin e Shqipërisë - "Specialist redaktor";

h) në administratën e Presidentit - "Specialist stenograf redaktor";

i) në Bibliotekën Kombëtare - nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes, përjashtuar titullarin dhe zëvendëstitullarin e institucionit;

j) në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Cirkun Kombëtar - punonjësit e trupës artistike në këto institucione.

**Lidhja nr. 5**

**Klasat e pagave për funksionarët e kabineteve të institucioneve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi dhe vlera e pagës bazë mujore të pozicioneve "zëvendësministër" dhe "sekretar"**

| Nr. rendor | Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor i kabinetit të Presidentit.<br>Drejtor i kabinetit të Kryeministrit.<br>Drejtor i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit.<br>Drejtor i Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm.<br>Drejtor i kabinetit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. | I-1 | 1 |
| 2 | Këshilltar i Presidentit.<br>Këshilltar i Kryeministrit.<br>Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit.<br>Këshilltar për protokollin i Kryeministrit.<br>Këshilltar për protokollin i Presidentit.<br>Zëdhënës i Presidentit.<br>Drejtor i kabinetit të Zëvendëskryeministrit.<br>Drejtor i kabinetit të Avokatit të Popullit.<br>Drejtor i kabinetit të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. | I-2 | 1 |
| 3 | Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm.<br>Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë.<br>Këshilltar i Avokatit të Popullit.<br>Këshilltar i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.<br>Drejtor i kabinetit të ministrit.<br>Drejtorë të kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.<br>Ndihmës i Presidentit.<br>Ndihmës i Kryeministrit.<br>Ndihmës i Kryetarit të Kuvendit.<br>Këshilltar i zëvendëskryeministrit.<br>Analist në kabinetin e Kryeministrit. | I-3 | 1 |
| 4 | Ndihmës i zëvendëskryeministrit.<br>Ndihmës i Nënkryetarit të Kuvendit.<br>Këshilltar i ministrit.<br>Këshilltar i titullarëve të institucioneve të tjera të | I-4 | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | pavarura të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.<br>Zëdhënës i titullarëve të institucioneve të pavarura të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi. | | |

| Nr. Rendor | Pozicioni | Vlera e pagës bazë mujore të pozicionit të punës (lek/muaj) |
|---|---|---|
| 1 | Zëvendësministër. | 0.85 e pagës së ministrit |
| 2 | Prefekt. | 205 000 |
| 3 | Nënprefekt. | 170 000 |
| 2 | Sekretar i Presidentit.<br>Sekretar i Kryeministrit.<br>Sekretar i Kryetarit të Kuvendit.<br>Sekretar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë.<br>Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm.<br>Sekretar i zëvendëskryeministrit.<br>Sekretar i Nënkryetarit të Kuvendit.<br>Sekretar i Avokatit të Popullit.<br>Këshilltar i Prefektit të qarkut Tiranë. | 90 000 |
| 3 | Sekretar i ministrit.<br>Sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit.<br>Sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.<br>Sekretar në Kryeministri.<br>Sekretar në aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.<br>Sekretar i organit kolegjial drejtues.<br>Zëdhënës i Prefektit të qarkut Tiranë. | 80 000 |

**Lidhja nr. 6**

**Klasat e pagave për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi**

| Institucioni | Pozicioni | Grupi i diplomës | Klasa e pagës |
|---|---|---|---|
| Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave | Inspektor i Lartë. | 1 | I-4 |
| | Ndihmësinspektor i Lartë | 1 | II-1 |
| Autoriteti i Mediave Audiovizive | Kryetar i Këshillit të Ankesave. | 1 | II-1 |
| | Anëtar i Këshillit të Ankesave.<br>Përgjegjës i studios së transmetimit. | 1 | III-1 |
| | Monitorues. | 1 ose 2, ose 3 | IV-2 |
| Autoriteti i Konkurrencës | Inspektor i mbikëqyrjes së tregut.<br>Inspektor i hetimit. | 1 | III-1 |
| Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | Inspektorë të ankesave dhe hetimit administrativ. | 1 | III-1 |
| Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | Inspektor. | 1 | III-1 |
| Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare | Inspektor. | 1 | III-1 |
| Komisioni i Prokurimit Publik | Inspektor. | 1 | III-1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi | Inspektor. | 1 | III-1 |
| Kryeministria | Drejtor njësie. | 1 | I-4 |
| | Jurist.<br>Inspektor.<br>Koordinator. | 1 | II-1 |
| | Koordinator. | 1 | III-1 |
| Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. | Koordinator në Sekretariatin (Drejtorinë e Përgjithshme) e BE-së. | 1 | III-1 |
| Ministria e Drejtësisë. | Koordinator në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit. | 1 | III-2 |
| Ministria përgjegjëse për financat | Koordinator në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. | 1 | III-2 |
| Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror | Përmbarues gjyqësor shtetëror. | 1 | II-1 |
| | Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit. | 1 | III-1 |
| Institucionet e pavarura | Inspektor (auditues i brendshëm) në drejtoritë e auditimit të brendshëm, apo sektorët e auditimit të brendshëm. | 1 ose 2 | IV-1 |

**Lidhja nr. 7**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Sekretar i Përgjithshëm në:<br>Kryeministri, Presidencë, Kuvend, Prokurori të Përgjithshme, Avokatin e Popullit. | I-1 | 1 |
| Sekretar i Përgjithshëm në ministri dhe institucionet e tjera të pavarura.<br>Drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.<br>Drejtor Departamenti në Kryeministri. | I-2 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave të sektorit që mbulon institucioni, si dhe për çështjet rregullatore).<br>Ndihmëskomisioner kategoria e parë në institucionin e Avokatit të Popullit.<br>Zëvendësdrejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.<br>Kancelar i Gjykatës së Lartë. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse. | I-5 | 1 |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave të sektorit që mbulon institucioni, si dhe për çështjet rregullatore).<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Ndihmëskomisioner kategoria e dytë në institucionin e Avokatit të Popullit. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme. | III-1 | 1 |
| Përgjegjës Sektori.<br>Kryesekretar gjyqësor. | III-1 | 1 |
| | III-2 | 1 |
| Specialist.<br>Sekretar gjyqësor. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |
| Këshilltar ligjor jomagjistratë në Gjykatën e Lartë. | Paga bruto fillestare e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. | Sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. |

**Lidhja nr. 7/1**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Pjesa e I - Niveli i parë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm | | |
| Kancelar. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Ndihmësligjor në gjykatat e apelit. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Kryesekretar.<br>Përgjegjës sektori. | III-1 | 1 |
| Përgjegjës sektori. | III-2 | 1 |
| Sekretar gjyqësor.<br>Sekretar në sekretarinë e prokurorisë.<br>Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | |
| Pjesa e II - Niveli i dytë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm | | |
| Kancelar.<br>Ndihmësligjor në gjykatat e apelit. | II-1 | 1 |
| Drejtor drejtorie. | II-2 | 1 |
| Kryesekretar.<br>Përgjegjës sektori. | III-2 | 1 |
| Sekretar gjyqësor. | IV-1 | 1 ose 2 |

| | | |
|---|---|---|
| Sekretar në sekretarinë e prokurorisë. | | |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | |
| Pjesa e III - Niveli i tretë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm | | |
| Ndihmësligjor në gjykatat e apelit. | II-1 | 1 |
| Kancelar. | III-1 | 1 |
| Kryesekretar.<br>Përgjegjës sektori. | IV-1 | 1 |
| Sekretar gjyqësor.<br>Sekretar në sekretarinë e prokurorisë.<br>Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| Specialist. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 7/2/a**

## Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Drejtor i kabinetit të Kryetarit të KLGj-së.<br>Drejtor i kabinetit të Kryetarit të KLP-së. | I-1 | 1 |
| Këshilltar në kabinetin e Kryetarit të KLGj-së.<br>Këshilltar në kabinetin e Kryetarit të KLP-së. | I-2 | 1 |
| Ndihmës në kabinetin e Kryetarit të KLP-së. | III-1 | 1 |
| Sekretar i Kryetarit të KLGj-së.<br>Sekretar i Kryetarit të KLP-së. | Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit | |

**Lidhja nr. 7/2/b**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Sekretar i Përgjithshëm. | I-1 | 1 |
| Drejtor Departamenti. | I-3 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes.<br>Drejtor njësie.<br>Nëpunës në njësinë përgjegjëse për vlerësimin e profesionalizmit dhe etikës së gjyqtarëve për vettingun në KLGj. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse. | I-5 | 1 |
| Këshilltar i komisioneve të përhershme në KLGJ.<br>Këshilltar në departamentin/njësinë përgjegjëse për shërbimet ligjore në KLP.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Përgjegjës/Shef Sektori. | III-1 | 1 |
| | III-2 | 1 |
| Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | |

**Lidhja nr. 7/3/a**

## Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Këshilltar në kabinet. | I-2 | 1 |
| Koordinator. | I-3 | 1 |
| Sekretar. | Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit | |

**Lidhja nr. 7/3/b**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Kancelar. | I-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Ekspert. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Përgjegjës Sektori. | III-1<br>III-2 | 1 |
| Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2<br>IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 7/4/a**

## Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Drejtor i kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. | I-1 | 1 |
| Këshilltar në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. | I-2 | 1 |
| Ndihmës në kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. | III-1 | 1 |
| Sekretar i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. | Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit | |

**Lidhja nr. 7/4/b**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Sekretar i Përgjithshëm. | I-1 | 1 |
| Inspektorë (jomagjistratë). | I-3 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse. | I-5 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Ndihmës të inspektorëve. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Përgjegjës sektori. | III-1 | 1 |

| | | |
|---|---|---|
| | III-2 | |
| Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | |

**Lidhja nr. 7/5**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës në Shkollën e Magjistraturës**

| **Pozicioni** | **Klasa e pagës** | **Grupi i diplomës** |
|---|---|---|
| Kancelar. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Këshilltar Akademik.<br>Këshilltar për Botimet dhe Publikimet Shkencore. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Përgjegjës sektori. | III-1 | 1 |
| | III-2 | 1 |
| Redaktor shkencor.<br>Sekretar shkencor. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist.<br>Bibliograf.<br>Redaktor letrar. | IV-1 | 1 ose 2 |
| | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 8**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "Titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës, 1, të kreut I, të këtij vendimi**

| **Pozicioni** | **Klasa e pagës** | **Grupi i diplomës** |
|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-2 | 1 |
| Zëvendëstitullar i Agjencisë për Media dhe Informim. | I-3 | 1 |
| Drejtor njësie në Departamentin e Administratës Publike. | I-4 | 1 |
| Zv/titullar i institucionit.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.<br>Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.<br>Koordinator në Agjencinë për Media dhe Informim.<br>Zëdhënës i ministrit. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Përgjegjës Sektori.<br>Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.<br>Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.<br>Ndërmjetës në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.<br>Analist në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës. | III-1 | 1 |
| Përgjegjës sektori.<br>Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.<br>Koordinator në njësitë organizative të përmbajtjes në Departamentin e Administratës Publike.<br>Inspektor në Agjencinë e Prokurimit Publik. | III-2 | 1 |
| Specialist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 8/1**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-2 | 1 | 90 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit. | II-1 | 1 | 70 000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI.<br>Drejtor drejtorie të drejtorive IT të atashuara pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore. | II-1 | 1 | 70 000 |
| Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | II-1 | 1 | 0 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 | 0 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI. | III-1 | 1 | 50 000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore. | III-2 | 1 | 40 000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor. | III-3 | 1 | 32 000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës. | III-2 | 1 | 0 |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në zyrën qendrore të AKSHI. | IV-1 | 1 ose 2 | 60 000 |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë Kryeministrisë, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.<br>Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore. | IV-1 | 1 ose 2 | 45 000 |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 50 000 |
| | IV-4 | | |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |
| | IV-3 | | 0 |

**Lidhja nr. 8/2**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-2 | 1 | 55 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit | II-1 | 1 | 50 000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes. | II-1 | 1 | 50 000 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 | 0 |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes. | III-1 | 1 | 40 000 |
| Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës. | III-2 | 1 | 0 |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes. | IV-1 | 1 ose 2 | 30 000 |
| Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |
| | IV-3 | | 0 |

**Lidhja nr. 8/3**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Drejtor drejtorie. | II-2 | 1 |
| Jurist. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| Sekretar. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 9**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Titullar i institucionit.<br>Kryetar i Komitetit për Pakicat Kombëtare. | I-3 | 1 |
| Zv/titullar i institucionit.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.<br>Auditues i Parë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse.<br>Anëtar i organit drejtues. | II-2 | 1 |
| Auditues i Dytë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian. | III-1 | 1 |
| Përgjegjës Sektori. | III-1 | 1 |
| | III-2 | |
| | III-3 | |
| Inspektor.<br>Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |

**Lidhja nr. 9/1**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni", në Inspektoratin Qendror**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-3 | 1 | 15 000 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. | II-1 | 1 | 15 000 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 | 0 |
| Përgjegjës i sektorit të përmbajtjes. | III-1 | 1 | 20 000 |
| | III-2 | | |
| Përgjegjës i sektorit mbështetës. | III-2 | 1 | 0 |
| Specialist një njësitë e përmbajtjes. | IV-1 | 1 ose 2 | 25 000 |
| Specialist në njësitë mbështetëse. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |

**Lidhja nr. 9/2**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave**

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Drejtor i Përgjithshëm. | I-3 | 1 | 120 000 |
| Zv/drejtor i Përgjithshëm. Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. | II-1 | 1 | 110 000 |
| Drejtor i drejtorisë përgjegjëse për koordinimin juridik | II-1 | 1 | 90 000 |
| Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | II-1 | 1 | 0 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 | 0 |
| Përgjegjës i sektorit të përmbajtjes. | III-1 | 1 | 100 000 |
| Përgjegjës në drejtorinë për koordinimin juridik | III-1 | 1 | 70 000 |
| Përgjegjës i sektorit mbështetës. | III-1 | | |
| | III-2 | 1 | 0 |
| Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes. | IV-1 | 1 ose 2 | 90 000 |
| Specialist në drejtorinë për koordinimin juridik | IV-1 | 1 | 60 000 |
| Specialist në njësitë organizative mbështetëse. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |

**Lidhja nr. 9/3**

## Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit doganor

| Klasifikimi doganor | Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Paga bazë mujore e pozicionit | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|---|---|
| | Titullar i Institucionit. | I-3 | 1 | | 20 000 |
| | Zv/drejtor i përgjithshëm. | II-1 | 1 | | 15 000 |
| A | Drejtor kabineti.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Kryetar i degës doganore të kategorisë A sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore. | II-1 | 1 | | 15 000 |
| A | Drejtor i drejtorive mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme.<br>Këshilltar. | II-2 | 1 | | 15 000 |
| A | Përfaqësues SELEC në DPD. | III-1 | 1 | | 15 000 |
| B | Kryetar i degës doganore të kategorisë B sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore. | II-2 | 1 | | 14 000 |
| B | Përgjegjës i sektorit të përmbajtjes në DPD. | III-1 | 1 | | 14 000 |
| B | Përgjegjës i sektorit mbështetës në DPD | III-2 | 1 | | 14 000 |
| B | Përgjegjës sektori në degët doganore të kategorisë A. | III-2 | 1 | | 14 000 |
| **C1** | <u>Në DPD:</u><br>Auditues. Specialist. Specialist laborant. Komandant Grupi Antikondrabande. Specialist QNOD. Përgjegjës zyre.<br><br><u>Në degët doganore:</u><br>Përgjegjës zyre/turni. Specialist (analist risku, aposterior, jurist, borxhi, administrator rrjeti, financier). | IV-1 | 1 ose 2 | | 14 000 |
| **C2** | <u>Në DPD:</u><br>Inspektor antikondrabande. Asistent laborant. Specialist. Specialist GFI. Doganier klasifikim/vlerësim/aposterior.<br><br><u>Në degët doganore:</u><br>Specialist finance i nivelit të dytë. Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik/skaner/akcizë/aposterior/regjime/preferenca/përjashtime. | IV-2 | 1 ose 2 ose 3 | | 10 000 |
| **C3** | <u>Në DPD:</u><br>Sekretar/protokoll. Arkivist. Përpunues informacioni. Doganier pike kontrolli.<br><br><u>Në degët doganore:</u><br>Doganier peshoreje/pike kontrolli. Sekretar. Arkivist. | | | 47 000 | 5 000 |
| **D1** | <u>Në DPD:</u><br>Magazinier. Teknik marinë/motorist. Teknik mirëmbajtjeje. Shofer.<br><br><u>Në degët doganore:</u><br>Magazinier. | | | 45 600 | |
| **D2** | Punëtor mirëmbajtjeje në degë doganore. | | | Klasa IV Sipas VKM për pagat e punonjësve mbështetës | |
| **D3** | Sanitar/Punonjës pastrimi në DPD dhe degë doganore. | | | Klasa I Sipas VKM për pagat e punonjësve mbështetës | |

**Lidhja nr. 9/4**

**Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit tatimor**

| **Pozicioni** | **Klasa e pagës** | **Grupi i diplomës** | **Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)** |
|---|---|---|---|
| Drejtor i përgjithshëm. | I-3 | 1 | 20 000 |
| Zv/drejtor i përgjithshëm. Drejtor kabineti.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes në drejtorinë e përgjithshme.<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Drejtor i drejtorisë rajonale. | II-1 | 1 | 15 000 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. | II-2 | 1 | 15 000 |
| Këshilltar në kabinet.<br>Përgjegjës/shef i sektorit të përmbajtjes në drejtorinë e përgjithshme.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes në drejtoritë rajonale. | III-1 | 1 | 14.000 |
| Përgjegjës/Shef i sektorit mbështetës në drejtorinë e përgjithshme.<br>Drejtor i drejtorive mbështetëse në drejtoritë rajonale. | III-2 | 1 | 14 000 |
| Inspektor në njësinë përgjegjëse për kontrollin e specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. | III-2 | 1 | 14.000 |
| Përgjegjës/Shef sektori/Zyre të përmbajtjes në drejtoritë e rajonale. | III-3 | 1 | 12 000 |
| Inspektor i parë.<br>Inspektor i auditit të brendshëm.<br>Inspektor hetimi në drejtorinë e përgjithshme. | IV-1 | 1 ose 2 | 12 000 |
| Përgjegjës zyre në Task-Forcë. | IV-1 | 1 ose 2 | 17.000 |
| Inspektor i dytë.<br>Specialist në drejtorinë e përgjithshme.<br>Inspektor hetimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale.<br>Specialist në njësitë e përmbajtjes dhe në njësitë juridike në drejtoritë rajonale. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 12.000 |
| Specialist në drejtorinë e përgjithshme.<br>Inspektor hetimi.<br>Inspektor.<br>Specialist në drejtoritë rajonale. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 10.000 |
| Specialist. | IV-4 | 1 ose 2, ose 3 | 5.000 |
| Sekretar në drejtorinë e përgjithshme. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 5.000 |
| Sekretar në drejtoritë rajonale. | IV-4 | 1 ose 2, ose 3 | 5.000 |

**Lidhja nr. 9/5**

## Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës | Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj) |
|---|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-3 | 1 | 20 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit. | II-1 | 1 | 10.000 |
| Drejtor i Drejtorisë së SHKBB. | II-1 | 1 | 15 000 |
| Drejtor i drejtorive të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | II-1 | 1 | 6 000 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse në drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. | II-2 | 1 | 6 000 |
| Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Drejtorinë e SHKBB. | III-1 | 1 | 10 000 |
| Përgjegjës i sektorëve mbështetës në Drejtorinë e SHKBB. | III-2 | 1 | 10 000 |
| Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. | III-1 | 1 | 6 000 |
| Përgjegjës i sektorëve mbështetës Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. | III-2 | 1 | 6 000 |
| Specialist/Inspektor në drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. | IV-1 | 1 ose 2 | 5 000 |
| Specialist/inspektor në Drejtorinë e SHKBB. | IV-1 | 1 ose 2 | 10 000 |
| Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në SHKB. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 5 000 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |
| Specialist. | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 | 0 |

**Lidhja nr. 10**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Titullar i institucionit. | I-4 | 1 |
| Zv/titullar i institucionit.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse.<br>Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve. | II-2 | 1 |
| Kapiten i Porteve.<br>Përgjegjës departamenti në Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore.<br>Menaxher cilësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit.<br>Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara.<br>Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara.<br>Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. | III-1 | 1 |
| Kapiten i Portit. | III-2 | 1 |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjegjës sektori. | III-2<br>III-3 | 1 |
| | Kontrollor anketimi në INSTAT.<br>Topograf. | | |
| 8 | Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme.<br>Operator në INSTAT.<br>Administrator dokumentesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe në drejtoritë e arkivave në qarqe.<br>Magazinier. | V | |
| 9 | Operator.<br>Preparator.<br>Kolektor.<br>Punonjës blegtorie.<br>Drejtues mjetesh motorike/motobarke.<br>Punëtor i rasateve të peshkut.<br>Anketues.<br>Shofer për automjete mbi 2.5 tonë dhe automjete speciale. | IV | |
| 10 | Shofer.<br>Shaptilografist.<br>Fotokopjues.<br>Kaldaist.<br>Punëtor mirëmbajtës.<br>Punëtor porti.<br>Punonjës shërbimi. | III | |
| 11 | Nëpunës informacioni.<br>Centralist. | II | |
| 12 | Rojë.<br>Korrier.<br>Postier.<br>Lulishtar.<br>Punonjës pastrimi/sanitar. | I | |

**Kreu I/2**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës të punonjësve**
**të administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Kryeministrisë**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës | Shtesë për funksion drejtues (grupi) |
|---|---|---|---|
| 1 | Përgjegjës arkivi.<br>Përgjegjës administrate. | VIII | 4 |
| 2 | Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit. | VII | 3 |
| 3 | Arkivist.<br>Llogaritar.<br>Operator.<br>Kameraman.<br>Fotograf. | VII | |
| 4 | Punonjës shtypshkronje, shumëfishimi.<br>Teknik të specialiteteve të ndryshme.<br>Magazinier.<br>Recepsionist.<br>Shofer-korrier. | VI | |
| 5 | Punëtorë të tjerë.<br>Shofer. | V | |
| 6 | Punonjës pastrimi. | II | |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/3**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Punonjës i ruajtjes së rendit. | VII |
| 2 | Teknik mirëmbajtjeje.<br>Operator.<br>Magazinier.<br>Shofer i kryetarit. | VI |
| 3 | Shofer i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe i Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.<br>Shofer-korrier. | V |
| 4 | Shoferë të tjerë. | IV |
| 5 | Punonjës pastrimi. | II |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/ 4**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit.<br>Oficer informacioni në Prokurorinë e Posaçme.<br>Sekretar.<br>Punonjës i postës sekrete. | VII |
| 2 | Shofer drejtuesi në Prokurorinë e Posaçme.<br>Teknik mirëmbajtjeje.<br>Operator.<br>Magazinier. | VI |
| 3 | Shofer i postës sekrete.<br>Kuzhinier në Prokurorinë e Posaçme.<br>Shofer prokurori në Prokurorinë e Posaçme. | V |
| 4 | Shoferë të tjerë të institucionit. | IV |
| 5 | Punonjës pastrimi. | II |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/5**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të disa institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| **I** | **Në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar** | |
| 1 | Teknik gjeolog dhe të specialiteteve të ndryshme.<br>Punëtor (mjeshtër shpimi, sondist, special, armator, mekanik, specialist, elektricist, tornitor, saldator, axhustator, llamarinist). | VI |
| 2 | Operator.<br>Kompjuterist.<br>Heliografist.<br>Disenjator.<br>Kopist.<br>Shofer i ekspeditave. | V |
| 3 | Ndihmëssondist. | III |

| | | |
|---|---|---|
| | Ndihmësminator.<br>Ndihmësarmator.<br>Ndihmësteknik. | |
| **II** | **Në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera** | |
| 1 | Teknik i mesëm në:<br>- Laboratorin e provave të litarëve të çelikut;<br>- Emergjencën dhe shpëtimin;<br>- Mirëmbajtjen (kolaudimin) e pajisjeve shpëtuese;<br>- Mirëmbajtjen dhe kolaudimin e automjeteve. | VIII |
| 2 | Teknik i mesëm për komunikimin, informacionin dhe ruajtjen e institucionit.<br>Shofer i automjeteve të gatishmërisë. | VI |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/6**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, Institutit të Policisë Shkencore dhe Qendrës së Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Ndihmësmjek.<br>Bibliotekar.<br>Sekretar.<br>Kryekuzhinier.<br>Ndihmësfarmacist. | VI |
| 2 | Teknik armatimi.<br>Teknik ndërtimi.<br>Kujdestar/magazinier (për armatime dhe të tjera).<br>Infermier.<br>Kuzhinier. | V |
| 3 | Shofer autoambulance. | IV |
| 4 | Kartelist.<br>Evidencier.<br>Inventarizues.<br>Rrobaqepës.<br>Kamerier.<br>Kolaudator.<br>Furnitor. | III |
| 5 | Mirëmbajtës ushqimi.<br>Ndihmëskuzhinier.<br>Punonjës ngarkim-shkarkimi.<br>Zhbllokues. | II |
| 6 | Lulishtar.<br>Mirëmbajtës. | I |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/7**

## Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të disa institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për kulturën

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| **I** | **Në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe në Teatrin Kombëtar** | |
| 1 | Përgjegjës për bibliotekën muzikore në TOB;<br>Mjeshtër Skene;<br>Mjeshtër Ndriçimi/Fonie;<br>Mjeshtër Parukier-grimier;<br>Mjeshtër Rrobaqepës;<br>Mjeshtër Garderobier;<br>Mjeshtër i Dekorit;<br>Mjeshtër Marangoz;<br>Mjeshtër Rekuizite;<br>Mjeshtër Këpucar. | IX |
| 2 | Ndihmësmjeshtër grimier/rrobaqepës/rekuizitier/këpucar/marangozerie/i mekanikës skenike;<br>Punonjës marketingu. | VIII |
| 3 | Ndihmësmjeshtër ndriçim/fonie/rekuizitier/dekorator | VII |
| 4 | Punëtor skene | IV |
| 5 | Punëtor shërbimi | III |
| 6 | Biletashitës | II |
| II | **Në Galerinë Kombëtare të Arteve, Muzeun Historik Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Qendrën Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, Qendrën Muzeore Berat - Muzeun Ikonografik "Onufri" - Muzeun Etnografik Berat, Qendrën Muzeore Krujë - Muzeun "Skënderbeu" - Muzeun Etnografik Krujë, Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Cirkun Kombëtar** | |
| 1 | Restaurator në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore | VII |
| 2 | Ndihmësbibliotekar;<br>Piktor/skulptor/piktor ekzekutues në QKKF. | VI |
| 3 | Elektricist;<br>Fonist;<br>Butaforist. | V |
| 4 | Vëzhgues salle;<br>Ruajtës fondesh;<br>Fototekist;<br>Katalogues;<br>Punëtor restaurimesh. | III |
| 5 | Punëtor skene;<br>Gardërobier. | II |
| 6 | Biletashitës. | I |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/8**

## Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve qendrore

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Kontrollor cilësie në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit.<br>Mbikëqyrës riparimi në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit.<br>Manovrator në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. | VIII |

| | | |
|---|---|---|
| 2 | Montazhier grafist.<br>Ndihmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të IV në pajisjet tokësore dhe të nivelit të III në pajisjet ajrore.<br>Ofsetist në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake. | VII |
| 3 | Bibliotekar.<br>Sekretar.<br>Kryekuzhinier.<br>Farmacist.<br>Topograf.<br>Kryeinfermier.<br>Operator audioviziv.<br>Ndihmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të III në pajisjet tokësore dhe të nivelit të II në pajisjet ajrore. | VI |
| 4 | Teknik armatimi.<br>Teknik ndërtimi.<br>Kujdestar/magazinier (për armatime dhe të tjera).<br>Infermier.<br>Kuzhinier.<br>Faqosës.<br>Provokopist.<br>Fotograf e kopist.<br>Arkivist i fondeve filmike e fotografike.<br>Fotoreporter.<br>Furnitor/kolaudator në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit. | V |
| 5 | Shofer autoambulance.<br>Shofer automjeti transporti mbi 2.5 tonë. | IV |
| 6 | Kartelist.<br>Evidencier.<br>Inventarizues.<br>Rrobaqepës.<br>Ndihmësinstruktor.<br>Libralidhës.<br>Furnitor. | III |
| 7 | Mirëmbajtës ushqimi.<br>Ndihmëskuzhinier.<br>Punonjës ngarkim shkarkimi.<br>Zhbllokues.<br>Rrobalarës. | II |
| 8 | Lulishtar.<br>Mirëmbajtës. | I |

Shënim:

a) Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

b) Institucionet e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes që paguhen sipas kësaj lidhjeje janë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Shifrës, Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Komanda dhe Shtabi i Forcës Tokësore, Komanda dhe Shtabi i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, Komanda dhe Shtabi i Forcës Ajrore, Komanda dhe Shtabi i Komandës Mbështetëse, Qendra e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel Rekrutimit, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, Qendra e Arsimimit Profesional të nënoficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.

**Kreu I/9**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve civilë të Qendrës së Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Patrulluese për Rojën Bregdetare të Shqipërisë, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Teknik i kualifikuar në repartet e prodhimit të anijeve.<br>Teknik i kualifikuar në repartet e riparimit të anijeve. | VIII |
| 2 | Përpunues të projekteve e skicave.<br>Sekretar.<br>Përkthyes.<br>Kostoist/normist. | VII |
| 3 | Protokollist-arkivist.<br>Sekretar.<br>Operator.<br>Magazinier për karburantet. | VI |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/10**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës | Shtesë për funksion drejtues (grupi) |
|---|---|---|---|
| 1 | Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit) | IX | 3 |
| 2 | Përgjegjës (gjelbërimi, aktivitete të tjera ndihmëse). | VIII | |
| 3 | Kuzhinier.<br>Administrues hoteli.<br>Banakier. | VII | |
| 4 | Ndihmëskuzhinier. | VI | |
| 5 | Kamerier.<br>Recepsionist. | V | |
| 6 | Punonjës hotelerie.<br>Punonjës gjelbërimi. | II | |
| 7 | Punëtorë kuzhine;<br>Punëtorë restoranti;<br>Punëtorë lavanterie. | I | |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/11**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Shofer i kryetarit të KLGJ-së.<br>Shofer i kryetarit të KLP-së.<br>Teknik mirëmbajtjeje.<br>Magazinier. | VI |
| 2 | Shofer i anëtarit të KLGJ-së.<br>Shofer i anëtarit të KLP-së.<br>Shofer-korrier. | V |
| 3 | Nëpunës informacioni.<br>Shoferë të tjerë. | IV |
| 4 | Punonjës pastrimi. | II |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu II/1**

**Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi dhe të disa institucioneve të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës | Shtesë për funksion drejtues (grupi) |
|---|---|---|---|
| 1 | Manovrator i makinerive të rënda.<br>Manovrator në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. | XIII | |
| 2 | Ndihmësmanovrator i makinerive të rënda. | XII | |
| 3 | Punonjës i gjendjes civile në bashki. | XI | |
| 4 | Kryetar dege në arsimin parauniversitar.<br>Kryekujdestar në qendrat e përkujdesjes sociale.<br>Përgjegjës ofiçine e transporti.<br>Përgjegjës grupi në drejtoritë rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve dhe Drejtorinë e Riparimit të Makinerive të Furnizimit në Tiranë. | X | 3 |
| 5 | Punonjës i gjendjes civile në njësi administrative. | X | |
| 6 | Shofer me automjete speciale.<br>Kryesondist.<br>Shofer në sektorin e helikopterëve të Repartit Special "RENEA" në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes. | IX | |
| 7 | Meteorolog.<br>Ndihmësmjek.<br>Laborant.<br>Sekretar.<br>Sekretar shkolle në shkollat e arsimit të mesëm të lartë.<br>Kryekuzhinier.<br>Kryeinfermier.<br>Farmacist.<br>Arkivist.<br>Llogaritar/ekonomist i mesëm.<br>Shofer automjeti transporti mbi 2.5 tonë dhe mjeteve speciale.<br>Anketues.<br>Motopompist.<br>Topograf.<br>Teknik i mesëm në strukturat e teknologjisë së informacionit, në sistemin e Policisë së Shtetit. | VIII | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Roje mjedisore me arsim të lartë. | | |
| 8 | Sekretar shkolle në shkollat e arsimit bazë.<br>Arkiviste gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit.<br>Bibliotekar.<br>Programist.<br>Instruktor.<br>Metodist.<br>Kujdestar në qendrat e përkujdesjes sociale.<br>Shofer transporti me automjet mbi 2.5 tonë.<br>Administrator i sistemeve të ndërlidhjes.<br>Polombar.<br>Roje mjedisore me arsim të mesëm. | VII | |
| 9 | Teknik i mirëmbajtjes së pajisjeve tokësore, ajrore, detare, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes.<br>Minator.<br>Ndërlidhës.<br>Piktor.<br>Disenjator.<br>Punonjës sekretarie. | VI | |
| 10 | Teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme.<br>Teknik armatimi.<br>Kujdestar/magazinier (për armatime dhe të tjera).<br>Përgjegjës i godinave të shtëpive të pushimit.<br>Teknik ndërtimi.<br>Fenerist detar.<br>Ekspeditor.<br>Dispeçer.<br>Infermier.<br>Kuzhinier.<br>Fotograf.<br>Fotoreporter.<br>Telekronist.<br>Zetorist.<br>Operator audioviziv.<br>Montazhier grafist. | V | |
| 11 | Operator.<br>Magazinier.<br>Shofer autoambulance. | IV | |
| 12 | Kartelist.<br>Evidencier.<br>Inventarizues.<br>Rrobaqepës.<br>Kamerier.<br>Kolaudator.<br>Kopjues notash.<br>Daktilografist.<br>Fotokopjues.<br>Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme.<br>Punëtorë të bazave prodhuese.<br>Shofer autoveture.<br>Shofer automjeti transporti deri 2.5 tonë.<br>Roje me armë.<br>Ftues.<br>Furnitor.<br>Fillrojtës. | III | |
| 13 | Ndihmëskuzhinier.<br>Kaldaist.<br>Drejtues të motoçikletave dhe motokarrove.<br>Punonjës ngarkim shkarkimi.<br>Zhbllokues; | II | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Gardërobier.<br>Këpucar.<br>Berber. | | |
| 14 | Lulishtar.<br>Pjatalarës.<br>Rrobalarës.<br>Biletashitës.<br>Roje pa armë.<br>Punonjës shërbimi.<br>Sanitar/pastrues.<br>Korrier.<br>Centralist. | I | |

Shënim. Institucionet e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes që paguhen sipas kësaj lidhjeje janë: Shtëpitë e Pushimit të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, batalionet/ kompanitë/qendrat stërvitore në Forcën Tokësore, distriktet detare/flotiljet detare/Shërbimi Hidrografik/Qendra e Vëzhgimit Detar/Qendra e Zhytjeve/Qendra Stërvitore/ Kompanitë mbështetëse në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimi Meteorologjik Ushtarak / Qendra e Kontroll Raportimit/Qendra Stërvitore/Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/ Kompani/Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/Qendra në Akademinë e Forcave të Armatosura.

**Kreu II/2**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të drejtorive rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Magazinier. | VII |
| 2 | Punëtorë ngarkim-shkarkimi. | IV |
| 3 | Inventarizues.<br>Punëtorë. | II |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu II/1.

**Kreu II/3**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale**

| Nr. rendor | Emërtimi i pozicionit | Klasa e pagës |
|---|---|---|
| 1 | Shofer autoambulance, autoburgu;<br>Ndihmësmjek. | VIII |
| 2 | Kujdestar. | VII |
| 3 | Ndihmësfarmacist dhe magazinier. | V |

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu II/1.

**VENDIM**
**Nr. 327, datë 31.5.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËRCAKTIMIN E KLASËS SË PAGËS SË DIPLOMATËVE TË KARRIERËS QË PUNOJNË NË MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 39, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen diplomatët e karrierës që punojnë në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.
2. Paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ai kryen, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.
4. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, emërohen:
a) "Përgjegjës sektori", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Sekretar i parë" apo të barasvlershme me të;
b) "Drejtor drejtorie", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Këshilltar" apo të barasvlershme me të;
c) "Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme", nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se "Ministër Këshilltar" apo të barasvlershme me të.
5. Në rastet kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm, me gradë më të lartë se minimumi i përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ata paguhen sipas gradës diplomatike/konsullore, që kanë.
6. Vendimi nr. 881, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe përcaktimin e kategorisë së pagës së nëpunësve me grada diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme", i ndryshuar, shfuqizohet.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.
8. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

| Nr. | Grada diplomatike | Pozicioni | Klasa e pagës |
|---|---|---|---|
| 1 | Ambasador. | Sekretar i Përgjithshëm | I-2 |
| 2 | Ministër Fuqiplotë.<br>Ministër Këshilltar.<br>Konsull i Përgjithshëm. | Drejtor i Përgjithshëm | I-4 |
| 3 | Këshilltar. | Drejtor drejtorie. | II-1 |
| 4 | Sekretar i Parë.<br>Konsull. | Përgjegjës sektori. | III-1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | Sekretar i Dytë.<br>Zëvendëskonsull. | Specialist. | IV-1 |
| 6 | Sekretar i Tretë.<br>Agjent Konsullor. | Specialist. | IV-2 |
| 7 | Atashe. | Specialist. | IV-3 |

**VENDIM**
**Nr. 328, datë 31.5.2023**

**PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 2, shkronjat "a" e "ç", dhe 9, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", dhe të neneve 54 e 77, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grupimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, me përjashtim të Bashkisë së Tiranës dhe Këshillit të Qarkut, bëhet në bazë të numrit të banorëve të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Kufijtë e pagave mujore për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Klasat dhe kategoritë për pozicionet e punës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element për funksionarët e kabineteve dhe për nëpunësit civilë janë, si më poshtë vijon:

a) Klasat dhe kategoritë për pozicionet e punës së nëpunësve civilë përcaktohen në kolonat 1 dhe 2, të lidhjeve përkatëse nr. 2 deri në nr. 8, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

b) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, përcaktohet sipas kufijve minimalë dhe maksimalë në kolonën 5, të lidhjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

c) Shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjeve përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Vlerat e shtesës së nivelit të kualifikimit përcaktohen në lidhjen nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, "vite pune" do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, si dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

d) Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune).

4. Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për "specialistët", "përgjegjësit e sektorit" apo "drejtorët e drejtorive", të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit "Master i shkencave"/"Master profesional" / "Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni", "Shkenca kompjuterike", "Teknologji informacioni",

"Informatikë ekonomike", "Informatikë biznesi", "Inxhinieri-matematike-informatike" dhe "Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)", është, si më poshtë vijon:

a) 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të Bashkisë Tiranë, të bashkive me mbi 100 001 banorë;

b) 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive deri në 100 000 banorë.

Miratimi i këtyre shtesave bëhet, rast pas rasti, nga këshillat përkatës, pas verifikimit nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore për llojin e diplomës dhe për përshkrimin e pozicionit të punës.

5. Kategoritë e pagave për pozicionet "sekretar" janë, si më poshtë vijon:

a) Sekretar i kryetarit të Bashkisë Tiranë, kategoria IV-a, e lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Sekretar i kryetarëve të bashkive të tjera, kategoria IV-b, e lidhjeve nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 e nr. 7, që bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, në përputhje me numrin e banorëve të secilës bashki;

c) Sekretar i kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë, kategoria IV-b, e lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Kategoritë e pagave për funksionarët e kabineteve janë, si më poshtë vijon:

a) Drejtori i kabinetit në Bashkinë e Tiranës dhe sekretari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, kategoria II-a, të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Këshilltari i kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zëdhënësi, kategoria II-b, e lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Drejtori i kabinetit të Këshillit të Qarkut dhe sekretari i Këshillit të Qarkut, kategoria I-b, e lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Këshilltari i kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe zëdhënësi, kategoria II-b, e lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Drejtori i kabinetit dhe sekretari i Këshillit Bashkiak, për bashkitë e tjera, kategoria II-b, e lidhjeve nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 e nr. 7, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

dh) Këshilltari i kryetarit të Bashkisë dhe zëdhënësi, për bashkitë e tjera, kategoria III-a/1, e lidhjeve nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 e nr. 7, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

7. Kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Këshilli i qarkut dhe këshilli i bashkisë miratojnë vlerën e pagës, brenda kufijve të pagave, për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar dhe për çdo të punësuar të përcaktuar, përkatësisht, në lidhjet nr. 1 deri nr. 9, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

9. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njësimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave.

10. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur, me ligj, është parashikuar ndryshe, duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të bashkisë përkatëse.

11. Kufijtë e pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore janë nga 40 000–47 000 lekë në muaj.

12. Punonjësit administrativë, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

13. Prefekti, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në fillim të çdo viti informon zyrtarisht secilën bashki mbi numrin e banorëve të tyre, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

14. Vendimi nr. 165, datë 2.3.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen:

a) për nivelet e pagave sipas kufirit minimal, nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023;

b) për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal, nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

16. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

**Kufijtë e pagave mujore për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore**

a) Për Bashkinë e Tiranës:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 268 000 | 318 750 |
| Nënkryetar | 205 000 | 255 000 |

b) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me mbi 200 001 banorë:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 150 000 | 185 000 |
| Nënkryetar | 120 000 | 160 000 |

c) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100 001–200 000 banorë:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 130 000 | 170 000 |
| Nënkryetar | 100 000 | 145 000 |

ç) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50 001–100 000 banorë:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 90 000 | 145 000 |
| Nënkryetar | 80 000 | 125 000 |

d) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20 001–50 000 banorë:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 80 000 | 125 000 |
| Nënkryetar | 65 000 | 105 000 |

dh) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20 000 banorë:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 65 000 | 105 000 |
| Nënkryetar | 45 000 | 95 000 |

e) Për Këshillin e Qarkut:

| Emërtimi | Kufiri minimal në lek/muaj | Kufiri maksimal në lek në muaj |
|---|---|---|
| Kryetar | 110 000 | 170 000 |
| Nënkryetar | 80 000 | 125 000 |

**Lidhja nr. 2**

## Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i Përgjithshëm. | 1 | Nga 79 500 deri 217 000 |
| II | II-a | Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave që mbulon njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe për çështjet rregullatore). | 1 | Nga 76 500 deri 180 000 |
| | II-a/1 | Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse. | 1 | Nga 76 500 deri 170 000 |
| | II-b | Drejtor i drejtorive të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave që mbulon njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe për çështjet rregullatore).<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar. | 1 | Nga 68 000 deri 155 000 |
| | II-b/1 | Drejtor i drejtorive mbështetëse. | 1 | Nga 68 000 deri 141 000 |
| III | III-a | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 40 200 deri 115 000 |
| | III-a/1 | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 37 000 deri 105 000 |
| | III-b | Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2 | Nga 34 900 deri 80 000 |
| IV | IV-a | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 32 700 deri 70 000 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 600 deri 60 000 |

**Lidhja nr. 3**

## Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë mbi 200.000 banorë

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 79 500 deri 131 700 |
| II | II-a | Drejtor i përgjithshëm | 1 | Nga 76 500 deri 112 500 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 68 000<br>deri<br>91 000 |
| III | III-a | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 40 200<br>deri<br>80 300 |
| | III-a/1 | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 37 000<br>deri<br>73 900 |
| | III-b | Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2 | Nga 34 900<br>deri<br>70 000 |
| IV | IV-a | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 32 700<br>deri<br>56 000 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>44 000 |

**Lidhja nr. 4**

**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 100.001–200.000 banorë**

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 68 000<br>deri<br>112 500 |
| II | II-a | Drejtor i përgjithshëm | 1 | Nga 40 200<br>deri<br>91 000 |
| | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 37 000<br>deri<br>80 300 |
| III | III-a | Përgjegjës sektori<br>Kryeinspektor | 1 | Nga 35 800<br><br>deri 78 000 |
| | III-a/1 | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 34 900<br><br>deri 73 900 |
| | III-b | Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2 | Nga 34 900<br>deri<br>70 000 |
| IV | IV-a | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | Nga 32 700<br>deri<br>56 000 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>44 000 |

**Lidhja nr. 5**

## Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 50.001–100.000 banorë

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 40 200<br>deri<br>91 000 |
| II | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 34 900<br>deri<br>73 900 |
| | III-a/1 | Përgjegjës sektori<br>Kryeinspektor | 1 | Nga 34 900<br>deri<br>70 000 |
| | III-b | Përgjegjës sektori<br>Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2 | Nga 32 700<br>deri<br>56 000 |
| IV | IV-a | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>44 000 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>34 500 |

**Lidhja nr. 6**

## Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 20.001–50.000 banorë

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 37 000<br>deri<br>80 000 |
| II | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 34 900<br>deri<br>70 000 |
| III | III-a/1 | Përgjegjës sektori<br>Kryeinspektor | 1 | Nga 32 700<br>deri<br>56 000 |
| | III-b | Përgjegjës sektori | 1 ose 2 | Nga 32 700<br>deri<br>49 500 |
| IV | IV-a | Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>41 600 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | Nga 30 600<br>deri<br>34 500 |

**Lidhja nr. 7**

**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me deri në 20.000 banorë**

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 34 900 deri 70 000 |
| II | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 32 700 deri 56 000 |
| III | III-a/1 | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 32 700 deri 49 500 |
| | III-b | Përgjegjës sektori | 1 ose 2 | Nga 30 100 deri 41 600 |
| IV | IV-a | Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 000 deri 37 200 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2, ose 3 | Nga 30 000 deri 31 700 |

**Lidhja nr. 8**

**Nivelet e pagave për nëpunesit civilë në Këshillin e Qarkut**

| Klasa | Kategoria | Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| I | I-b | Sekretar i përgjithshëm | 1 | Nga 68 000 deri 112 500 |
| II | II-b | Drejtor drejtorie | 1 | Nga 40 200 deri 91 000 |
| III | III-a/1 | Përgjegjës sektori | 1 | Nga 37 000 deri 80 300 |
| | III-b | Përgjegjës sektori<br>Specialist<br>Inspektor | 1 ose 2 | Nga 34 900 deri 70 000 |
| IV | IV-a | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | Nga 32 700 deri 56 000 |
| | IV-b | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | Nga 30 600 deri 44 000 |

**Lidhja nr. 9**

**Kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative**

| | Pozicioni | Kufiri minimal i pagës | Kufiri maksimal i pagës |
|---|---|---|---|
| 1 | Administrator në njësitë administrative me 50.001–100.000 banorë. | 76 000 | 139 000 lekë |
| 2 | Administratornë njësitë administrative me 20.001–50.000 banorë. | 60 000 | 109 000 lekë |
| 3 | Administratornë njësitë administrative me 5.001–20.000 banorë. | 50 000 | 95 000 lekë |
| 4 | Administrator në njësitë administrative me më pak se 5.000 banorë. | 50 000 | 80 000 lekë |

**Lidhja nr. 10**

| Grupi i diplomës | Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) | Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj) |
|---|---|---|
| 1 | Niveli 7 i KSHK-së<br>(Master i shkencave.<br>Master i arteve.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 14 000 lekë |
| 2 | Niveli 7 i KSHK-së<br>(Master profesional.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 12 000 lekë |
| 3 | Niveli 6 i KSHK-së<br>(Bachelor.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.) | 10 000 lekë |

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 90
Datë: 2023/06/21 13:31:01
99807db0-ae26-45c2-a542-5c86d32e33de

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |


Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 320 lekë